



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

**“Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore
nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët, Faza IV - Materiale
elektrike”**

Specifikimet Teknike

Gusht, 2026

“TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” & “ERALD G”

KONSULENTI:



Përmbajtja

1.	Të përgjithshme	2
2.	Tuba plastik HDPE 100.....	5
3.	Tub plastmasi te brinjezuar me mufte.....	5
4.	Tuba te brinjezuar HDPE.....	5
5.	Rakorderi HDPE	6
6.	Tuba betoni.....	7
7.	Transporti i materialeve	8

1. Të përgjithshme

1.1 Objekti

Këto Specifikime Teknike përcaktojnë kërkesat minimale teknike, standardet, karakteristikat fizike dhe mekanike, kushtet e paketimit, transportit, magazinimit, dorëzimit dhe pranimit të materialeve që do të furnizohen në kuadër të projektit:

" Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët, Faza IV - Materiale për ujësjellës-kanalizime ".

Të gjitha materialet duhet të jenë të reja, të papërdorura, të cilësisë së parë dhe në përputhje me kërkesat e këtyre specifikimeve teknike.

1.2 Standardet e aplikueshme

Materialet duhet të jenë në përputhje me standardet evropiane të referuara në këto Specifikime Teknike ose me standarde ekuivalente ndërkombëtare të njohura.

Kur në këto specifikime referohen standarde të caktuara, do të pranohen edhe standarde ekuivalente që garantojnë të njëjtin nivel cilësie, sigurie dhe performance.

Në rast mospërputhjeje ndërmjet dokumentacionit teknik dhe standardeve të referuara, do të mbizotërojnë kërkesat më strikte.

1.3 Dokumentacioni teknik

Për çdo material të furnizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë sipas rastit:

- Certifikatë cilësie nga prodhuesi;
- Deklaratë konformiteti;
- Fletë teknike të produktit;
- Raporte testimi laboratorik ose certifikata prove, kur kërkohen;
- Dokumentacion që vërteton përputhshmërinë me standardet e kërkuara.

Dokumentacioni teknik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim në gjuhën shqipe

1.4 Kontrolli i cilësisë

Autoriteti Kontraktor ose strukturat e autorizuara prej tij kanë të drejtë të kryejnë verifikime dhe kontrole të cilësisë së materialeve para dhe gjatë dorëzimit.

Për materialet e dorëzuara mund të kërkohen mostra për verifikimin e karakteristikave teknike të deklaruara.

Në rast se gjatë kontrollit ose testimeve konstatohet se materiali nuk përmbush kërkesat e specifikuara, ai do të refuzohet dhe do të zëvendësohet nga kontraktori pa kosto shtesë.

1.5 Mostrat

Autoriteti Kontraktor ose strukturat e autorizuara prej tij kanë të drejtë të kërkojnë mostra për çdo material të parashikuar në këtë procedurë.

Mostrat duhet të jenë përfaqësuese të materialeve që do të furnizohen dhe të shoqërohen me dokumentacionin teknik përkatës.

Miratimi i mostrave nuk e përjashton kontraktorin nga përgjegjësia për furnizimin e materialeve në përputhje me kërkesat e kontratës dhe të specifikimeve teknike.

1.6 Paketimi dhe magazinimi

Materialet duhet të pakëtohen, ruhen dhe transportohen në mënyrë të tillë që të mos pësojnë dëmtime mekanike, fizike ose kimike.

Paketimi duhet të sigurojë mbrojtje ndaj:

- Lagështisë;
- Rrezeve të diellit, kur është e nevojshme;
- Dëmtimeve mekanike;
- Ndotjes;
- Faktorëve të tjerë atmosferikë.

Materialet që kërkojnë kushte të veçanta magazinimi duhet të ruhen sipas rekomandimeve të prodhuesit.

1.7 Transporti dhe Dorëzimi

Kontraktori do të mbulojë të gjitha shpenzimet për ngarkimin, transportin, shkarkimin dhe sistemimin e materialeve në vendmagazinimet e përcaktuara nga bashkitë përfituese.

Materialet do të konsiderohen të dorëzuara vetëm pas verifikimit dhe marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur nga bashkia përkatëse.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka të drejtë të verifikojë:

- Sasitë e dorëzuara;
- Përputhshmërinë me specifikimet teknike;
- Dokumentacionin shoqërues;
- Gjendjen fizike të materialeve.

Në rast konstatimi të mangësive ose mospërputhjeve, komisioni ka të drejtë të refuzojë marrjen në dorëzim të materialeve.

Materialet e dëmtuara gjatë ngarkimit, transportit, shkarkimit apo magazinimit deri në momentin e marrjes në dorëzim do të zëvendësohen nga kontraktori me materiale të reja dhe në përputhje me specifikimet teknike, pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor ose bashkinë përfituese.

Në rast se konstatohen mangësi në cilësi, sasi ose dokumentacion, komisioni ka të drejtë të refuzojë marrjen në dorëzim të materialeve deri në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kontratë dhe në specifikimet teknike.

1.8 Refuzimi i materialeve

Autoriteti Kontraktor ose strukturat e autorizuara prej tij kanë të drejtë të refuzojë materialet kur:

- Nuk përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike;
- Nuk janë në përputhje me standardet e kërkuara;
- Nuk shoqërohen me dokumentacionin përkatës;
- Paraqesin dëmtime fizike;
- Nuk përputhen me mostrat e miratuara, kur kërkohet paraqitja e mostrave.

Materialet e refuzuara do të zëvendësohen nga kontraktori brenda afateve të përcaktuara kontraktuale dhe pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

1.9 Garancia e cilësisë

Kontraktori garanton që materialet e furnizuara janë në përputhje me kërkesat e specifikuar dhe me karakteristikat teknike të deklaruara nga prodhuesi.

Çdo material që rezulton me defekte, mospërputhje ose cilësi nën kërkesat e përcaktuara do të

zëvendësohet nga kontraktori me shpenzimet e veta.

1.10 Njësitë e matjes

Njësitë e matjes që do të përdoren për materialet e furnizuara do të jenë sipas preventivit dhe përshkrimeve teknike përkatëse, si:

- Metër linear (ml);
- Copë (copë);

2. Tuba plastik HDPE 100

Tubat duhet të jenë PE 100-RC për ujë të pijshëm dhe në përputhje me DIN 8074/8075, DIN EN 12201 për instalime në kanale pa shtrat rëre, të prodhuar me PE 100-RC me rezistencën më të lartë ndaj plasaritjeve të ngadalta (FNCT kërkesat minimale: ≥ 8760 h në përputhje me PAS 1075; $T=80^{\circ}\text{C}$, $\sigma=4$ N/mm², 2% Arkopal), të verifikuara në përputhje me të dyja DIN 8075 dhe DVGW GW 335 A2. Etiketimi i tubave të bëhen me lazer, duke përfshirë barkodin e gjurmueshmërisë së tipit 128-C, në përputhje me ISO 12176-4 të shtypur direkt mbi tub.

Tubat duhet të kenë miratime të përditësuara sipas PAS 1075, DVGW dhe EN 12201 të cilat Kontraktori do t'ia paraqesë Mbikëqyrësit.

Tubat me diametër deri në 63 mm duhet të jenë në përputhje me PAS 1075 Tipi 1, tuba me mure të ngurtë me një shtresë të prodhuar me PE100-RC ose në përputhje me PAS 1075 Tipi 2, tuba me dy shtresa, me shtresë mbrojtëse të integruar të prodhuar me PE 100 or PE 100-RC dhe që ka një shtresë mbrojtëse të brendshme prej PE 100-RC.

Tubat me diametër të barabartë dhe më të madhe se 75 mm do të jenë në përputhje me PAS 1075 Tipi 2, tuba me dy shtresa, me shtresë mbrojtëse të integruar të prodhuar me PE 100 or PE 100-RC dhe që ka një shtresë mbrojtëse të brendshme prej PE 100-RC.

Tubat sipas PAS 1075 Type 2, duhet të jenë me një shtresë treguese të integruar me ngjyrë të paktën 10% të trashësisë së murit të tubit në pjesën e jashtme për të lejuar një vlerësim të saktë të sipërfaqes së tubit.

Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së materialit sipas PAS 1075 do të kryhet nga testimet, inspektimet dhe certifikimet e miratuara. Prodhuuesi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 50001.

3. Tub plastmasi te brinjëzuar me mufte

Tubat e brinjëzuar të polietilenit duhet të jenë të projektuara në përputhje me DIN EN 16961/, dhe EN 13476/3, të përshtatshme për trafik të rëndë (SLW 60), me klasën e mëposhtme të ngurtësisë dhe vlerave përkatëse të ngurtësisë së unazës (EN ISO 9969):

Klasa e ngurtësisë	Vlerat e ngurtësisë së unazës
SN8	minimum 8 kN/m ²

Tubat duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa; të brinjëzuar nga jashtë dhe e lëmuar nga brenda. Manikotat e tubave duhet të jenë me fole dyshe dhe guarnicione EPDM ose rezistente ndaj vajit NBR. Trashësia e murit të brendshëm duhet të jetë e përshtatshme për të përballuar presionin e lartë të sistemit të pastrimit (120 bar) në përputhje me DIN 19523.

Trashësia minimale e murit do të jetë në përputhje me EN 13476. Karakteristikat e materialit përbërës të tubave duhet të plotësojnë kërkesat e EN13476. Identifikimi i tubave do të bëhet gjithashtu në përputhje me EN13476. Fleksibiliteti i unazës (aftësia për deformim pa thyerje) duhet të jetë minimumi 30%, në përputhje me EN 1446. Gjatësia e tubave të furnizuar në kantier do të jetë 6m.

4. Tuba te brinjëzuar HDPE

Tubat e brinjëzuar të polietilenit duhet të jenë të projektuara në përputhje me DIN EN 16961/, dhe EN 13476/3, të përshtatshme për trafik të rëndë (SLW 60), me klasën e mëposhtme të ngurtësisë dhe vlerave përkatëse të ngurtësisë së unazës (EN ISO 9969):

Klasa e ngurtësisë	Vlerat e ngurtësisë së unazës
SN8	minimum 8 kN/m ²

Tubat duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa; të brinjëzuar nga jashtë dhe e lëmuar nga brenda. Manikotat e tubave duhet të jenë me fole dyshe dhe guarnicione EPDM ose rezistente ndaj vajit NBR. Trashësia e murit të brendshëm duhet të jetë e përshtatshme për të përballuar presionin e lartë të sistemit të pastrimit (120 bar) në përputhje me DIN 19523.

Trashësia minimale e murit do të jetë në përputhje me EN 13476. Karakteristikat e materialit përbërës të tubave duhet të plotësojnë kërkesat e EN13476. Identifikimi i tubave do të bëhet gjithashtu në përputhje me EN13476. Fleksibiliteti i unazës (aftësia për deformim pa thyerje) duhet të jetë minimumi

30%, në përputhje me EN 1446. Gjatësia e tubave të furnizuar në kantier do të jetë 6m.

5. Rakorderi HDPE

Rakorderitë e polietilenit duhet të jenë të projektuara në përputhje me DIN EN 16961/, dhe EN 13476/3, të përshtatshme për trafik të rëndë (SLW 60), me klasën e mëposhtme të ngurtësisë dhe vlerave përkatëse të ngurtësisë së unazës (EN ISO 9969):

Klasa e ngurtësisë	Vlerat e ngurtësisë së unazës
SN8	minimum 8 kN/m ²

Rakorderitë duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa; të brinjëzuar nga jashtë dhe e lëmuar nga brenda. Manikotat e tubave duhet të jenë me fole dyshe dhe guarnicione EPDM ose rezistente ndaj vajit NBR. Trashësia e murit të brendshëm duhet të jetë e përshtatshme për të përballuar presionin e lartë të sistemit të pastrimit (120 bar) në përputhje me DIN 19523.

Trashësia minimale e murit do të jetë në përputhje me EN 13476. Karakteristikat e materialit përbërës të rakorderive duhet të plotësojnë kërkesat e EN13476. Identifikimi i tubave do të bëhet gjithashtu në përputhje me EN13476. Fleksibiliteti i unazës (aftësia për deformim pa thyerje) duhet të jetë minimumi 30%, në përputhje me EN 1446. Gjatësia e tubave të furnizuar në kantier do të jetë 6m.

Zerat e Materialeve:

- Tuba plastik HDPE 100 DN 20 mm Pn 10
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 25 mm Pn 10
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 32 mm Pn 10
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 40 mm Pn 10
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 50 mm, Pn 10
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 63 mm, Pn 10
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 75 mm, Pn 10
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 90 mm, Pn 10
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 110 mm, Pn 10
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 125 mm, Pn 10
- Tuba plastik HDPE 100 DN Ø 160 mm, Pn 10
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 75 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 80 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 90 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 100 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 110 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 140 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 150 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 160 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 200 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 250 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 300 mm
- Tub plastmasi te brinjezuar me muftë Ø 350 mm
- Tuba te brinjezuar HDPE d=315 mm
- Tuba te brinjezuar HDPE d=400 mm
- Tuba te brinjezuar HDPE d=500 mm
- Tuba te brinjezuar HDPE d=600 mm
- Tuba te brinjezuar HDPE d=800 mm
- Tuba te brinjezuar HDPE d=1000 mm
- Rakorderi HDPE d=315 mm
- Rakorderi HDPE d=400 mm
- Rakorderi HDPE d=500 mm
- Rakorderi HDPE d=600 mm
- Rakorderi HDPE d=800 mm
- Rakorderi HDPE d=1000 mm

6. Tuba betoni

5.1 Tuba b/a Ø 400 mm

Betoni i armuar do të jetë i klasës C25/30 me rezistencë karakteristike cilindrike në shtypje $f_{ck}=25$ N/mm². Rezistenca minimale në shtypje $F_n = 48$ kN/m sipas standardit BS 9295:2010.

5.2 Tuba b/a Ø 500 mm

Betoni i armuar do të jetë i klasës C25/30 me rezistencë karakteristike cilindrike në shtypje $f_{ck}=25$ N/mm². Rezistenca minimale në shtypje $F_n = 60$ kN/m sipas standardit BS 9295:2010.

5.3 Tuba b/a Ø 600 mm

Betoni i armuar do të jetë i klasës C25/30 me rezistencë karakteristike cilindrike në shtypje $f_{ck}=25$ N/mm². Rezistenca minimale në shtypje $F_n = 72$ kN/m sipas standardit BS 9295:2010

5.4 Tuba b/a Ø 800 mm

Çeliku i armimit do të jetë i klasës B500C, me rezistencë në rrjedhshmëri $f_{yk}=500$ N/mm² dhe deformacion karakteristik $\geq 7.5\%$. Betoni i armuar do të jetë i klasës C30/37 me rezistencë karakteristike cilindrike në shtypje $f_{ck}=30$ N/mm². Shtresa mbrojtëse e armaturës do të jetë 20mm nga faqja e shufrave të jashtme. Trashësia e murit të tubit jo më pak se 8 cm. Rezistenca minimale në shtypje $F_n = 96$ kN/m sipas standardit BS 9295:2010.

5.5 Tuba b/a Ø 1000 mm

Çeliku i armimit do të jetë i klasës B500C, me rezistencë në rrjedhshmëri $f_{yk}=500$ N/mm² dhe deformacion karakteristik $\geq 7.5\%$. Betoni i armuar do të jetë i klasës C30/37 me rezistencë karakteristike cilindrike në shtypje $f_{ck}=30$ N/mm². Shtresa mbrojtëse e armaturës do të jetë 20mm nga faqja e shufrave të jashtme. Trashësia e murit të tubit jo më pak se 10 cm. Rezistenca minimale në shtypje $F_n = 120$ kN/m sipas standardit BS 9295:2010.

5.6 Tuba b/a Ø 1200 mm

Çeliku i armimit do të jetë i klasës B500C, me rezistencë në rrjedhshmëri $f_{yk}=500$ N/mm² dhe deformacion karakteristik $\geq 7.5\%$. Betoni i armuar do të jetë i klasës C30/37 me rezistencë karakteristike cilindrike në shtypje $f_{ck}=30$ N/mm². Shtresa mbrojtëse e armaturës do të jetë 20mm nga faqja e shufrave të jashtme. Trashësia e murit të tubit jo më pak se 12 cm. Rezistenca minimale në shtypje $F_n = 144$ kN/m sipas standardit BS 9295:2010.

5.7 Tuba b/a Ø 1500 mm

Çeliku i armimit do të jetë i klasës B500C, me rezistencë në rrjedhshmëri $f_{yk}=500$ N/mm² dhe deformacion karakteristik $\geq 7.5\%$. Betoni i armuar do të jetë i klasës C30/37 me rezistencë karakteristike cilindrike në shtypje $f_{ck}=30$ N/mm². Shtresa mbrojtëse e armaturës do të jetë 20mm nga faqja e shufrave të jashtme. Trashësia e murit të tubit jo më pak se 14 cm. Rezistenca minimale në shtypje $F_n = 180$ kN/m sipas standardit BS 9295:2010.

Zerat e Materialeve:

- Tuba betoni Ø 400 mm
- Tuba betoni Ø 500 mm
- Tuba betoni Ø 600 mm
- Tuba b/a Ø 800 mm
- Tuba b/a Ø 1000 mm

-
- **Tuba b/a Ø 1200 mm**
 - **Tuba b/a Ø 1500 mm**

7. Transporti i materialeve .

Shpenzimet për ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e materialeve në vendmagazinimet e caktuara nga bashkitë, do të mbulojë kontraktori . Materialet do të quhen të dorëzuara pasi të merren në dorëzim nga komisioni i ngritur nga bashkia përkatëse . Materialet e dëmtuara gjatë transportit dhe shkarkimit do të zëvendësohen nga kontraktori pa kosto shtesë